



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 shtator 2012
Nr. ref.: AGJ297/12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KO57/12

Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/l-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës"

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Presidenti Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja e Republikës), Shkëlqesia e Saj, Atifete Jahjaga, përmes përfaqësuesve të autorizuar z. Xhafer Tahiri dhe znj. Ariana Qosaj Mustafa.

Baza juridike

2. Kërkesa është bazuar në nenin 84.9 dhe 113.2.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe Rregullin 56(1) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

3. Më 31 maj 2012, Presidentja e Republikës së Kosovës, përmes përfaqësuesve të saj ligjorë e parashtrori kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
4. Më 4 qershor 2012, Sekretariati i Gjykatës, në pajtim me Rregulloren e Punës, ia komunikoi kërkesën z. Jakup Krasniqi, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrit Agim Çeku, Ministër i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës.
5. Më 6 qershor 2012, Kryetari i Gjykatës e emëroi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
6. Më tutje, më 7 qershor 2012, Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës e dorëzoi përgjigjen në lidhje me kërkesën. Gjykata e mori përgjigjen nga Kryetari i Kuvendit më 18 qershor 2012.
7. Më 13 korrik 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për pranueshmërinë e kërkesës. Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për kërkesën në seancë të mbyllur, në të njëjtën datë.

Objekti i çështjes

8. Presidentja e Republikës së Kosovës “konteston kushtetutshmërinë e votimit për miratimin e Ligjit nr. 04/L-0B4 për “Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës” dhe ktheu për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës me Vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës.
9. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës së Kosovës i drejtohet Gjykatës për të shqyrtuar nëse ka pasur shkelje të Kushtetutës, respektivisht të nenit 80.4, gjatë votimit në Kuvend lidhur me Vendimin e Presidentes për Kthimin e ligjit për shqyrtim.
10. Sipas Presidentes së Republikës, çështjet për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese janë:

“A është cenuar Neni 80, paragrafi (4), i Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë votimit/aprovimit të Ligjit Nr. 04/LO84 “Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës” të rikthyer për rishqyrtim Kuvendit të Kosovës me Vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht a është cenuar kompetenca e Presidentit për kthim të ligjit në rishqyrtim e parapare me nenin 84 paragrafi 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?”

Përmbledhje e fakteve në lidhje me pyetjet në fjalë

11. Më 15 mars 2012, Ligji Nr. 04/L-084 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së) u miratua në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. 69 deputetë votuan për ligjin, përderisa nuk kishte vota kundër dhe/apo abstenime.
12. Më 26 mars 2012, teksti i aprovuar i Ligjit iu dorëzua Zyrës së Presidentit të Republikës për shpallje nga ana e Presidentit.
13. Më 3 prill 2012, Presidentja e Republikës së Kosovës solli Vendimin për të kthyer Ligjin në rishqyrtim (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi për kthimin e ligjit të miratuar)..
14. Bazë juridike që përmendet në Vendimin për Kthimin e Ligjit në Shqyrtim të 3 prillit 2012 ishte neni 84.6 i Kushtetutës.
15. Në pjesën operative të Vendimit, thuhej se "Presidentja e Republikës së Kosovës sjellë këtë Vendim për kthimin në shqyrtim dhe me propozimin e një neni të ri për miratim, Kuvendit të Republikës së Kosovës.
16. Në të vërtetë, Presidentja e Republikës i propozoi Kuvendit një paragraf të ri për nenin 27 të Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, si vijon:

"Në rast të mungesës së fondeve publike, Qeveria mund të bëjë shkurtime sa i përket përfitimeve nga ligji, për të mos rrezikuar sigurinë financiare të Kosovës."
17. Presidentja e Republikës konkludon në Vendimin për kthimin në shqyrtim të Ligjit të miratuar të 3 prillit 2012 se " Pa përfshirjen e këtij neni, do të rrezikohej funksioni demokratik i Institucioneve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e obligimeve dhe detyrave të marra përsipër me marrëveshjet ndërkombëtare, zbatimi i të cilave është sanksionuar me Kushtetutë".
18. Presidentja pastaj dha arsyet për Vendimin, duke argumentuar se, me nënshkrimin e Marrëveshjes për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Republika e Kosovës ka marrë përsipër përmbushjen e obligimeve të caktuara ndërkombëtare që do të mundësonin Kosovës të përfitonte mbështetje financiare në formë të huave të buta si dhe përkrahje teknike. Pastaj ajo argumentoi pse mos nënshkrimi i marrëveshjes me FMN do të shkaktonte dëm të shumëfishtë Republikës së Kosovës.
19. Vendimi i 3 prillit 2012 për të kthyer Ligjin e miratuar, u shqyrtua më pas nga Komisioni funksional për çështje të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës.
20. Megjithatë Komisioni nuk ishte për aprovimin e amendamentit siç ishte propozuar nga ana e Presidentes së Republikës.
21. Më 3 maj 2012, Kuvendi mbajti seancë plenare. Në bazë të transkriptimit të asaj seance të 3 majit 2012, pika e fundit e rendit të ditës ishte " Shqyrtimi i Vendimit të sjellë nga Presidentja e Kosovës për të shqyrtuar Ligjin e Pensioneve për Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës".
22. Kjo mund të vërehet nga transkripti që, pasi që u bë e ditur se janë prezent 71 deputetë, Kryetari i Kuvendit deklaroi si në vijim: "në mënyrë që të miratohet Kërkesa e Presidentes është e domosdoshme që të bëhen 61 vota:. Përfundimisht, në trasnkript

thuhet: "Ne konkludojmë se me 29 vota "për", 34 "kundër" dhe 2 "abstenime", Kuvendi nuk e miraton amendamentin e propozuar nga Presidentja".

23. Gjithashtu më 3 maj 2012, Kryetari i Kuvendit mori Vendim për t'a bërë të ditur se: "1. Kuvendi nuk ka miratuar amendamentin e propozuar nga Presidentja e Kosovës për Ligjin nr. 04/L-84 për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës". Më tej thuhet: "Ligji nr. 04/L-84 për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë, mbetet siç është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 15 mars 2012, dhe konsiderohet i shpallur".

Përgjigjet nga palët

24. Më 7 qershor 2012, Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës u përgjigj, duke shprehur përkrahjen e tij që Gjykata të vendosë se a është shkelur neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit për FSK-së.
25. Më 18 qershor 2012, Kuvendi në përgjigjen e vet të, theksoi se shqyrtimi i vendimit të 3 prillit 2012, i dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit ishte në pajtim me nenin 80.4 të Kushtetutës.
26. Kuvendi po ashtu iu referua praktikës së mëparshme në situata të ngjashme si në vijim:
" nga 5 qershori 2008, kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi ka pasur raste kur me shumicën e votave të deputeteve të Kuvendit (pra me 61 vota "për") ka miratuar vërejtjet e presidentit në ligj dhe Ligji është konsideruar i shpallur me vërejtjet e presidentit, por ka pasur edhe raste kur Kuvendi nuk i ka miratuar vërejtjet e Presidentit (në mungesë të 61 votave "për") dhe ligji ka mbetur ashtu siç është miratuar më parë nga Kuvendi dhe është konsideruar i shpallur."
27. Në fund në përgjigjen e Kuvendit me tutje theksohej se *"Me rastin e vendimmarrjes në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me asnjë dispozite të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk është e paraparë që me rastin e miratimit të ndonjë akti në Kuvend të kërkohet për të votuar "Kundër" shumica e deputeteve të Kuvendit."*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka jurisdiksion për të vendosur vetëm për rastet të ngitura në mënyrë ligjore nga palë të autorizuara.
29. Neni 84.9 i Kushtetutës thotë si në vijim:

*"Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]
Presidenti i Republikës së Kosovës:*

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese..."

30. Është e qartë se në bazë të nenit 84(9) të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës është i autorizuar për të referuar çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese.
31. Gjykata Kushtetuese vëren se Presidentja e Kosovës ka shtruar dy pyetje si në vijim:

1) A është cenuar Neni 80, paragrafi (4), i Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë votimit/aprovimit të Ligjit Nr. 04/LO84 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Pensionet e Pjesëtarëve të FSK-së)?"

2) A është cenuar kompetenca e Presidentit për kthim të ligjit në rishqyrtim e parapare me nenin 84 paragrafi 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?"

32. Në mënyrë që Kërkesa të shpallet e pranueshme, Kushtetuta kërkon që çështjet e referuara në Gjykatë në mënyrë ligjore nga një palë e autorizuar, sipas nenit 113.3.1 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se pyetjet e Presidentes së Republikës janë shtruar në mënyrë ligjore. Gjykata Kushtetuese, si autoriteti final për interpretimin e Kushtetutës, poashtu konsideron se këto pyetje janë të natyrës kushtetuese. Prandaj Presidentja e Republikës ka shtruar pyetje kushtetuese dhe është një palë e autorizuar.
33. Pyetjet e shtruara janë pyetje kushtetuese siq përcakton neni 84(9) i Kushtetutës. Prandaj nuk është e nevojshme të shqyrtohet Kërkesa në kontekst të nenit 113.1 të Kushtetutës.
34. Rrjedhimisht, kërkesa është e pranueshme.

Meritat

35. Qysh në fillim, Gjykata do të dëshironte t'i referohej fakteve të lartpërmendura të rastit siç janë përmbledhur në paragrafin 16 dhe 17. Siç u përmend në pjesën operative, Vendimi i 3 prillit 2012, i sjellë nga Presidenti thuhej si në vijim: "Presidentja e Republikës së Kosovës sjellë këtë Vendim për kthimin në shqyrtim dhe me propozim të një neni të ri për miratim, drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës".
36. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës i propozoi Kuvendit një paragraf shtesë për nenin 27 të Ligjit për Pensionin e Pjesëtarëve të FSK-së.

Nëse kompetenca e Presidentes për të kthyer ligjin në rishqyrtim është shkelur?

37. Në mënyrë që të vlerësojë pyetjen e parë kushtetuese të parashtruar nga Presidentja, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Presidentja e Republikës kur ka ushtruar kompetencat siç përshkruhen në nenin 84 (6) të Kushtetutës ka të drejtë propozojë amendamente të Ligjit të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 80 (1) të Kushtetutës pa kontestuar ligjin e miratuar ose ndonjë nga dispozitat e tij të veçanta.
38. Gjykata vëren se Presidenti i Republikës nuk ka kthyer ndonjë dispozitë të veçantë të Ligjit të miratuar për Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së që ajo i konsideronte si të dëmshme, qoftë për interesat legjitime të Republikës ose të një apo më shumë komuniteteve të saj. Në vend të kësaj, Presidentja, propozoi një paragraf shtesë për nenin 27 të Ligjit për Pensione të pjesëtarëve të FSK-së
39. Në adresimin e kësaj çështje Gjykata duhet së pari të vlerësojë kompetencat kushtetuese të Presidentes për të kthyer ligjin e miratuar për shqyrtim siq përshkruhet me nenin 84.6 të Kushtetutës.
40. Neni 84.6 i Kushtetutës [Kompetencat e Presidentit] thotë:

"Presidenti i Republikës së Kosovës ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë".
41. Kjo dispozitë e Kushtetutës duhet të kuptohet në lidhje me nenin 80 paragrafët 3 dhe 5 të Kushtetutës që thotë:

" Neni 80 [Miratimi i Ligjit]

3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.

...

5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.”

42. Kushtetuta parasheh se Presidentja e Republikës ka të drejtën të ushtrojë të ashtuquajturën “veto suspensive” për të pezulluar shpalljen e ligjit.
43. Në këtë mënyrë, Presidentja e Republikës është kreu i shtetit që përfaqëson unitetin e popullit (siç përcakton neni 83 i Kushtetutës) dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, dhe ushtron funksion të caktuar shqyrtues legjislativ.
44. Kushtetuta vlerëson se ky funksion i Presidentes, siç parashihet me Kushtetutë, është më shumë e natyrës së kufizuar, *inter alia*, për arsyet në vijim.
45. Së pari, Presidentja mund të ushtrojë të drejtën për të pezulluar shpalljen e ligjit në fazën kur ligji tashmë i miratuar në formën e duhur në Kuvend (në pajtim me nenin 80.1 të Kushtetutës), duhet vetëm të bëhet efektiv (shih nenin 80 paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës). Vetëm atëherë, Presidentja mund të intervenojë.
46. Së dyti, Presidentja, duhet të intervenojë brenda tetë ditësh prej ditës së pranimit të ligjit të miratuar; përndryshe një ligj duhet të konsiderohet i shpallur në vijë me nenin 80.5 të Kushtetutës.
47. _____treti, Presidenti duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit në fjalë.
48. Këto arsye vetëm mund të ndërlihen me konsideratën e Presidentes se shpallja e ligjit është i dëmshëm qoftë për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj (shih neni 80.3 dhe 84.6 i Kushtetutës).
49. _____katërti, Presidentja mund të ushtrojë të drejtën e kthimit të një ligji vetëm një herë. (shih neni 80.3 i Kushtetutës).
50. Gjykata është në dijeni se e drejta e vetos së Presidentes për të kthyer nj lig në parlament mund të gjendet në një numër kushtetutash.
51. Për shembull, në Francë, neni 10 i Kushtetutës përcakton si në vijim:”*Presidenti i Republikës do të shpallë aktet e parlamentit brenda një periudhe prej 15 ditësh, pas miratimit dh transmetimit të tyre përfundimtar në qeveri. Para skadimit të këtij afati kohor, ai mundet, të kërkojë nga parlamenti që të rishqyrtojë aktin ose disa nene të tij. Ky rishqyrtim nuk mund të refuzohet*”.
52. Në anën tjetër, neni 42 i Kushtetutës Greke përcakton si në vijim:

“Neni 42 [Ratifikimi i ligjeve, Vetoja]

(1) Presidenti i Republikës nxjerr dhe publikon ligjet e miratuara nga parlamenti brenda një muaji nga miratimi i tij. Presidenti i Republikës mundet, brenda afatit kohor të specifikuar në paragrafin e mësipërm, të dërgojë përsëri në Parlament një ligj të miratuar, duke theksuar arsyet për veton e tij.

(2) Një ligj ose ligji i një anëtari privat i vënë në veto nga Presidenti i Republikës duhet të silltet para seancës plenare të Parlamentit, dhe duhet të jetë miratuar përsëri nga shumica absolute e numrit të përgjithshëm të deputetëve, sipas procedurës së parashikuar në nenin 76 (2), Presidenti i Republikës nxjerr dhe publikon ligjin e tillë brenda dhjetë ditësh nga miratimi i tyre.”

53. Për më tepër, Kushtetuta e Bullgarisë në nenin 101 definon Vetën e Presidentit si në vijim:

“Neni 101 [Vetoja]

(1) Brenda afatit të përcaktuar me nenin 88(3), Presidenti është i lirë të kthejë një ligj, së bashku me motivet e tij, në Asamblesë Kombëtare për diskutim të mëtejshëm, i cili nuk do të mohohet.

(2) Miratimi i ri i ligjit të tillë kërkon shumicën e më shumë së gjysmës së të gjithë anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.

(3) Pas një miratimi të ri të ligjit nga Asambleja Kombëtare, Presidenti do të shpallë atë brenda shtatë ditësh pas marrjes së tij”.

54. Për më tepër, neni 72 i Kushtetutës së Lituanisë përcakton procedurat në vijim:

“Seimat mund të shqyrtojnë dhe të miratojnë një ligj të ri të referuar përsëri nga Presidenti i Republikës.

Ligji i shqyrtuar nga Seimat do të konsiderohet i miratuar me kusht që amendamentet dhe shtesat e paraqitura nga Presidenti i Republikës të jenë të miratuara ose nëse më shumë se $\frac{1}{2}$ e të gjithë Anëtarëve të Seimas të kenë votuar për ligjin, dhe nëse është një ligj kushtetues- nëse jo atëherë $\frac{3}{5}$ e të gjithë Anëtarëve të Seimas do të votojnë për të.

Presidenti i republikës duhet që brenda tri ditësh të nënshkruajë dhe menjëherë zyrtarisht të shpallë ligjet e tilla.”

55. Për më tepër, sipas nenit 1, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, : Çdo Ligj i cili do të miratohet në Dhomën e Përfaqësuesve dhe Senatit, duhet, para së të bëhet Ligj, t'i paraqitet Presidentit të Shteteve të Bashkuara; nëse ai e miraton duhet ta nënshkruajë, por nëse jo ai duhet ta kthejë, me Vërejtjet e tij tek ajo Dhomë nga e cila e ka origjinën, e cila do të fusë Vërejtjet në Gazetën e tyre, dhe do të vazhdojë me rishqyrtimin. Nëse pas një Rishqyrtimit të tillë dy të tretat e asaj Dhome do të bien dakord për ta miratuar Ligjin, ai duhet të dërgohet, së bashku me Vërejtjet, në Dhomën tjetër, nga e cila gjithashtu duhet të rishqyrtohet, dhe nëse miratohet nga dz të tretat e asaj Dhome, do të bëhet Ligj. Por në të gjitha rastet e tilla Vota e të dy Dhomave do të përcaktohen nga Po-të dhe Jo-të, dhe nga Emrat e Personave që votojnë për dhe kundër Ligjit duhet të hyjnë në Gazetën e secilës Dhomë përkatëse. Nëse ndonjë Ligj do të kthehet nga Presidenti brenda dhjetë ditësh (përjashtohen të dielat) pasi t;i jenë paraqitur atij, i njëjti do të bëhet Ligj, në të njëjtën mënyrë sikur ta kishte nënshkruar ai, përveç nëse Kongresi me Shtyrjet e tyre parandalon Kthimin e tij, në këtë rast nuk do të bëhet Ligj”.

56. Përfundimisht, neni 136 (Fuqizimi dhe Veto) i Kushtetutës së Portugalisë përcakton se:

“1. Brenda njëzet ditësh nga marrja e çdo dekreti nga Kuvendi i Republikës për miratimin si ligj, ose nga publikimi i ndonjë vendimi të Gjykatës Kushtetuese që nuk shpallë ndonjë nga dispozitat e dekretit jokushtetuese, Presidenti i republikës duhet ose të fuqizojë dekretin ose të ushtrojë të drejtën e vetos. Në rastin e fundit, ai duhet të dërgojë mesazh dhe të përcaktojë arsyet për këtë dhe të kërkojë që të rishqyrtohet statuti.

2. Nëse Kuvendi i Republikës konfirmon votën e vet origjinale me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve në ushtrimin e plotë të detyrës së tyre, Presidenti i Republikës do të fuqizojë dekretin brenda tetë ditësh nga marrja e tij”.

57. Duke iu kthyer rastit në fjalë, Gjykata vëren se Presidentja e Republikës, më r prill 2012, mori Vendimin për ta thyer ligjin e miratuar brenda afatit kohor të përcaktuar me Kushtetutë. Gjykata gjithashtu vëren se bazë juridike ishte neni 84.6
58. Gjykata më tej vëren se Kushtetuta e Kosovës, ngjashëm si Kushtetutat e lartpërmendura, obligon Presidentin që të theksojë arsyet specifike të kthimit të ligjit në Kuvend.
59. Në disa vende si Lituania, Kushtetuta në mënyrë explicite përcakton se Presidenti i Republikës mund të dorëzojë amendamentet dhe shtesat në ligjin e kthyer.
60. Ky rast nuk ndodhë në Republikën e Kosovës.
61. Në te vërtetë, Kushtetuta e Kosovës nuk përcakton se Presidenti i Republikës ka të drejtë të propozojë amendamentet e ligjit të kthyer për rishqyrtim.
62. Gjykata është e vetëdijshme se neni 79 i Kushtetutës përshkruan se Presidenti mund të marrë nismën për të propozuar ligje nga fushë veprimtaria e tij/saj.
63. Ajo dispozitë e Kushtetutës është elaboruar më tej në nenin 53.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës që thotë:

“Propozim të Projektligjit në Kuvend mund ta paraqesë Presidenti i Republikës së Kosovës, nga fusha e veprimtarisë së tij...”

64. Rregullorja e punës së Kuvendit më tej elaboron në nenin 54 kushtet për të paraqitur një Projekt-Ligj, siç është notë sqarimi, deklarimi i implikimeve buxhetore, etj.
65. Sidoqoftë, Presidenti i Republikës në rastin konkret nuk ka ushtruar të drejtën sipas nenin 79 të Kushtetutës dhe siç elaborohet më tutje në nenin 53,1 dhe 54 të Rregullores së Punës së Kuvendit për të paraqitur Ligjin dhe /ose amendamentet në Kuvend.
66. Rrjedhimisht, në bazë të fakteve të përshkruara më sipër, Gjykata vlerëson se kompetenca e Presidentes së Republikës për kthimin e ligjit për rishqyrtim, sic përcakton neni 84(6) i Kushtetutës, nuk është shkelur.

Nëse neni 80 (4) i Kushtetutës së republikës së Kosovës është shkelur gjatë procedurës së votimit/miratimit

67. Gjykata tani dëshiron shqyrtojë pyetjen e dytë të shtruar nga Presidentja si në vijim: Nëse neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është shkelur gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit nr. 04/L-084, për Pensionet e Pjesëtarëve të FSK?
68. Gjykata është e vetëdijshme se elaborimi i pyetjes së dytë mund të konsiderohet e tepërt , vis-a-vis me gjetjet në pyetjen e parë kushtetuese.
69. Gjykata është e mendimit se është një obligim i qartë i Kuvendit të Kosovës përcaktuar në nenin 80.4 të Kushtetutës si në vijim

“Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit...”


70. Sidoqoftë, obligimi i tillë i Kuvendit të Kosovës nuk ekziston në rast së Presidentja e Republikës propozon amendamentet për ligjin e kthyer në shqyrtim.
71. Pavarësisht që Gjykata, si gardiani i Kushtetutës dhe interpretuesi përfundimtar i saj, konsideron se është e nevojshme të përgjigjet në të gjitha pyetjet kushtetuese të parashtruara në këtë kërkesë.
72. Sipas procedurave të miratimit të ligjit Neni 80 [Miratimi i Ligjeve] parasheh si më poshtë:
- “1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.*
- 3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.*
- 4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.*
- 5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.*
- 6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.”*
73. Gjykata përkujton që Kushtetuta bënë dallim në mes termit “shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë” dhe “shumicën e votave të të gjithë deputetëve”.
74. Gjykata Kushtetuese vë në dukje se Kushtetuta në shumë vende e përdor termin “të gjithë deputetët”, sikur në Nenin 76, 86 (4), 86(5), 90 (2).
75. Gjykata Kushtetuese përkujton se Kuvendi i Republikës së Kosovës përbëhet prej 120 deputetëve. Rrjedhimisht, kur Kushtetuta i referohet “të gjithë deputetët”, në të vërtetë i referohet “120 deputetët”
76. Rrjedhimisht, parashihet që Presidenti i Republikës të ushtrojë fuqinë e vetos siç është përkrahur në Nenin 80.3 të Kushtetutës, për ta përmbysur veton e Presidentit nevojiten që së paku 61 deputetë të votojnë në favor të ligjit të miratuar i cili është kthyer nga Presidenti i Republikës.
77. Prandaj, bazuar në faktet e përshkruara më sipër, Gjykata konsideron që gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit nr. 04/L-OB4 për “Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës” nuk është shkelur Neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

PËR KËTO ARSYE GJYKATA, NJËZËRI, VENDOSI SI MË POSHTË:


- I. Kërkesa është e pranueshme;
- II. Kompetencat e Presidentit të Republikës për të kthyer për shqyrtim ligjet, siç parashihet me Nenin 84 (6) të Kushtetutës, bazuar në faktet e përshkruara në Aktgjykim, nuk janë shkelur.
- III. Rrjedhimisht, gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit nr. 04/L-OB4 për “Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës” nuk është shkelur Neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës
- IV. Ky Aktgjykim do t’u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtar raportues

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese


Altay Surøy




Prof. dr. Enver Hasani